



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROJEKT

V E N D I M

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN 647 TË DATËS 24.05.2019 PËR MIRATIMIN E
VËZHguesve AFATGJATË NGA KRIIK PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 21.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anetare

OBJEKT: Për një shtesë në vendimin 647 të datës 24.05.2019 për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të paraqitur nga KRIIK për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

V Ë R E N

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) është një organizatë e cila ka si mision mbrojtjen dhe garantimin e lirive e të drejtave të njeriut si dhe të dimensionit të plotë të sigurisë njerëzore nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës, qeverisjes demokratike, nxitjes së aktivizimit e të angazhimit qytetar si dhe



Nr. 842 i Vendimit

Data 21 .06.2019 Ora 10⁰⁰ e Vendimit

Për një shtesë në vendimin 647 të datës 24.05.2019 për miratimin e vëzhguesve afatgjatë nga KRIIK Albania për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019.

nxitjes për përgjegjshmëri, transparencë e llogaridhënie të plotë të institucioneve publike dhe politike.

Kjo organizatë ka paraqitur kërkesën e saj me nr. Prot11801, datë 17.06.2019, bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 106 (njëqind e gjashtë) vëzhguesve afatgjatë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4,5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e KRIIK Albania për akreditimin e 106 (njëqind e gjashtë) vëzhguesve afatgjatë për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare



Nr. 842 i Vendimit

Data 21 .06.2019 Ora 10⁰⁰ e Vendimit

Për një shtesë në vendimin 647 të datës 24.05.2019 për miratimin e vëzhguesve afatgjatë nga KRIIK Albania për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019.